

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SH.A;
NJOFTIM PËR MODIFIKIMIN E KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor:

Emri: Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a;
Adresa: Rruga "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë;
Tel: +355 42 228 349, +355 42 239 295;
E-mail: info@kesh.al;
Ueb-faqe: www.kesh.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri: B.Mukaj
E-mail: mukajb@kesh.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur/Punë publike.

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuadër: Punë Publike/ Kontratë me Çmim Njësie të bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në Preventivin në Njësi.

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: Nr. REF- 13749-07-22-2024.

6. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër: "Mbrojtje dhe sistemim me prita malore i përroit të Gomsiqes".

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Punë ndërtimi 45000000-7.

8. Fondi limit: 216,000,000 (Dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion) lek pa TVSH.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Modifikimi i kontratës është realizuar sipas parashikimeve ligjore të nenit 127, pika 1, shkronja c e ligjit Nr.162 datë 23/12/2020 "Për Prokurimin Publik", sipas së cilit modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve:

Të dhënat e kontratës:

Objekti i Kontratës: "Mbrojtje dhe sistemim me prita malore i përroit të Gomsiqes".

Vlera e kontratës: 251,718,454.95 (Dyqind e pesëdhjetë e një milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër pikë nëntëdhjetë e pesë) Lekë me TVSH.

Afati i kontratës: Data e fillimit të punimeve është data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, në prani të Kontraktorit dhe Mbikëqyrësit të punimeve. Në këtë datë do të mbahet procesverbali i fillimit të punimeve.

Afati për realizimin e punimeve është 7.5 (shtatë pikë pesë) muaj, sipas grafikut të punimeve, nga data e fillimit të punimeve.

Shënim: Në afatin e zbatimit të punimeve nuk do të përfshihen, periudha nga nënshkrimi i kontratës, miratimi i lejeve sipas legjislacionit në fuqi deri në dorëzimin e sheshit të ndërtimit dhe festat zyrtare. Ky proces duhet të jetë i dokumentuar.

Kur dita e fundit e afatit të kontratës bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj (për të cilën nuk aplikohen penalitete).

Data e fillimit të punimeve : 06.10.2025.

Modifikimi i kontratës është realizuar sipas parashikimeve ligjore të :

- Neni 127, pika 1, shkronja c e ligjit Nr.162 datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas së cilit modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike.
- Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, përkatësisht neni 27 - Zgjatja e afatit.
- Në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, udhëzimit nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.
- Në zbatim të Vendimit Nr. 610 datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrë e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

Kërkesat teknike për zgjatjen e afatit të zbatimit të kontratës janë përcjellë nga Kontraktori, Mbikëqyrësi i punimeve dhe nga Struktura Përgjegjëse e Autoritetit Kontraktor.

Bazuar në dokumentacionin teknik midis palëve, modifikimi i kësaj kontrate është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga Autoriteti Kontraktor, pasi:

Referuar shkresave zyrtare të Mbikëqyrësit të punimeve citohet se:

Në bazë të Kontratës së Mbikëqyrjes Nr.25/3 Prot. datë 04/03/2025 lidhur midis Autoritetit Kontraktor “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a” dhe B.O.E “Civil Cons” sh.p.k & “ARGI” sh.p.k & “TRIANGLE” sh.p.k në cilësinë e Mbikëqyrësit të Punimeve në objektin “Mbrojtje dhe sistemim me prita malore i përroit të Gomsiqes”, ju bëjmë me dije:

Punimet e zbatimit për objektin “Mbrojtje dhe sistemim me prita malore i përroit të Gomsiqes” kanë filluar në datë 06/10/2025. Afati i Kontratës së Sipërmarrjes Nr.1661/12 datë 21/01/2025 është 7.5 muaj nga data e fillimit të punimeve dhe rrjedhimisht afati i përfundimit të punimeve është 21/05/2026.

Gjatë periudhës 25/10/2025 – 15/11/2025, për shkak të reshjeve të dendura të shiut ka patur një rritje të menjëhershme të nivelit të ujit të shoqëruar me vërshime të përroit duke pamundësuar zbatimin e punimeve si dhe janë dëmtuar punimet e pritave të realizuara deri në atë periudhë. Për këtë arsye në datë 17/11/2025 është bërë pezullimi i punimeve, për të cilin është mbajtur proces-verbali përkatës si dhe është njoftuar zyrtarisht Autoriteti Kontraktor.

Gjatë periudhës 17/11/2025 – 20/04/2026, objekti ka qënë i pezulluar , kjo për shkak të nivelit të lartë të ujit, gjë që në këto kushte nuk është bërë e mundur të kryhet asnjë punim.

Në njoftimin e bërë me datë 21.04.2026 “Për rifillim punimesh” është bërë një rillogaritje nga ana e Kontraktorit për afatet kompesuese të punimeve, ndërprerjeve për arsye të reshjeve dhe pezullimit të punimeve. Në bazë të kushteve në të cilat ndodhet objekti, nga ana e Kontraktorit është kërkuar zgjatje e afatit të kontratës me 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) ditë. Për sa më sipër, si dhe referuar shkresës së Sipërmarrësit Nr.120 Prot. Date 24/04/2026, kërkojmë nga ana juaj amendimin e afatit të punimeve në përputhje me Nenin 27 të Kontratës së Sipërmarrjes Nr.1661/12 datë 21/01/2025. (Bashkëlidhur kësaj shkrese është paraqitur kërkesa e Sipërmarrësit për zgjatje afati, dokumentacioni Teknik përfshirë edhe ditari i objektit ku janë pasqyruar ditët e ndërprerjeve si dhe ditari i objektit për ditët me reshje).

Përsa më sipër, kërkohet një shtyrje afati prej 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) ditë për përfundimin e punimeve të zbatimit.

Struktura Përgjegjëse e Autoritetit Kontraktor, pas verifikimeve, analizave të fakteve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit teknik ka vlerësuar dhe dakortësuar këtë zgjatje afati prej 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) ditë.

Kontrata është modifikuar vetëm në zgjatjen e afatit të zbatimit të saj, dhe jo në natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: 251,718,454.95 (Dyqind e pesëdhjetë e një milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër pikë nëntëdhjetë e pesë) Lekë me TVSH.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): Nuk është rasti.

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër:

Data e fillimit të punimeve është data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, në prani të Kontraktorit dhe Mbikëqyrësit të punimeve. Në këtë datë do të mbahet procesverbali i fillimit të punimeve.

Afati për realizimin e punimeve është 7.5 (shtatë pikë pesë) muaj, sipas grafikut të punimeve, nga data e fillimit të punimeve.

Shënim: Në afatin e zbatimit të punimeve nuk do të përfshihen, periudha nga nënshkrimi i kontratës, miratimi i lejeve sipas legjislacionit në fuqi deri në dorëzimin e sheshit të ndërtimit dhe festat zyrtare. Ky proces duhet të jetë i dokumentuar.

Kur dita e fundit e afatit të kontratës bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj (për të cilën nuk aplikohen penalitete).

Dhe afati i ri (nëse është rasti): Afati për realizimin e punimeve do të përfundojë në datën 13/11/2026.

Kur dita e fundit e afatit të kontratës bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj (për të cilën nuk aplikohen penalitete).

Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:

OPERATORI EKONOMIK: "HASTOÇI" sh.p.k.

NIPT: J62028009B.

Adresa: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga "Pjetër Bogdani", Pallati Nr.17, Ap 5/3, përballë Kopshtit Nr.31, Tiranë;

Telefon: 0672082291;

E - mail: mynyrhastoci@yahoo.com;

15. Data e nënshkrimit të modifikimit : 21/05/2026.

16. Burimi i financimit: Nga të ardhurat e vet KESH sh.a.

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti kontraktor :

Kontrata është modifikuar vetëm në zgjatjen e afatit të zbatimit të saj, dhe jo në natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve.